

ANISA ÇUNI

**RRETH FJALËVE ME PREJARDHJE TË HUAJ DHE DREJTSHKRIMIT
TË TYRE NË SHQIPE**

Çfarë ka ndodhur me gjuhën shqipe në më shumë se katër dekada?

Kanë kaluar më shumë se katër dekada, që nga koha kur u hartua “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” (1973), ndaj mund të themi, se sot, gjuha shqipe funksionon në një kontekst tërësisht të ndryshëm kulturor dhe shoqëror, nga ai që ishte dje. Kanë ndryshuar jo vetëm rrethanat politike, por edhe ato shoqërore. Mandej kanë ndryshuar edhe kushtet social-politike, komunikimi ndërgjuhësor është rritur ndjeshëm midis vendeve të ndryshme të botës, teknologjia ka arritur majën, falë internetit, informacioni përhapet me shpejtësi marramendëse, si një epidemi ngjitëse për shoqërinë, si një qasje me gjuhët e globit, duke i infektuar të rinjtë me përdorime të fjalëve të shkurtra në komunikimet e tyre, si në jetën e përditshme, ashtu edhe në komunikimet e ndryshme në rrjetet sociale, facebook, twitter, instagram etj. si dhe me përdorimin vend e pa vend të fjalëve të huaja, duke i bërë të ndihen modernë, të kohës si bashkëmoshatarët e tyre në mbarë globin. Të gjithë këta faktorë ndikojnë përshpejtimin e procesit të zhvillimit edhe në gjuhë, sepse gjuha, si një mjet universal komunikimi ndërmjet njerëzve, nuk është një *ergon*¹, pra diçka e ngurtë (produkt) e dhënë njëherë e përgjithmonë, që nuk ndryshon, por një *energeia*² (aktivitet) pra diçka që është në ndryshim të pandërprerë. Të gjitha gjuhët e botës ndryshojnë, kështu edhe shqipja, (gjuha standarde), e cila është e lidhur drejtpërdrejt me identitetin kombëtar, gjuhësor e kulturor, për të përmbushur sa më mirë funksionin komunikativ ka pësuar ndryshime, si për mirë ashtu edhe për keq në rrjedhë të viteve, sidomos në rrafshin leksikor, pasi përpjekja e parë për të futur fjalë të huaja bëhet nëpërmjet tij. Ndërkaq ndryshime kanë ndodhur edhe në gramatikë, megjithëse ajo është një sistem i mbyllur dhe si e tillë është më pak e prekur nga trysnitë e brendshme dhe jashtëgjuhësore. Rrjedhimisht risitë sintaksore janë më të pakta. Ato gjenden më së shumti në përkthimet e ndryshme (kryesisht në ndërtimin e fjalive³), të cilat ndikohen drejtpërsëdrejti nga gjuha e huaj, ato i kanë sjellë kryesisht shkrimtarët, shkencëtarët dhe sidomos përkthyesit, të cilët i përmbahen materialit origjinal.

Po aktualisht, në çfarë gjendje është gjuha shqipe?

“Beteja” e shqipes për fjalët me prejardhje të huaj është në “luftë” të pa ndërprerë, edhe pse kemi një drejtshkrim, të cilit duhet t’i përmbahemi dhe rregullat e tij duhet të jenë normë për të gjithë, në fakt ajo që dominon më shumë në shoqërinë tonë (në shekullin e XXI) është shkujdesja ndaj normës së gjuhës,

¹ W. von Humboldt, 1836, LVII.

² W. von Humboldt, 1836, LVII.

³ R. Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit – Tridhjetë vjet pas*, Tiranë, 2003, f. 36-41.

devijimi i rregullave standarde të saj, mënjanimi i fjalës shqipe dhe zëvendësimin e saj me fjalë të huaja të panevojshme, megjithëse shqipja i ka gjegjëset e saj. Mjafton një vëzhgim i thjeshtë apo thjesht dhe vetëm të dëgjosh dhe të shikosh emisione televizive (tituj), radio, të lexosh gazeta të ndryshme, të dëgjosh politikanë të Kuvendit të Shqipërisë, gazetarë dhe të ftuar në studiot televizive; të shfletosh dokumentacionin e institucioneve, ku punojnë titullarë dhe shtetarë, dallon qartazi, se në të gjithë të sipërpërmendurit, por jo vetëm dëshirën për të folur me fjalë të huaja, përpjekjen për ta zëvendësuar pa kriter, vend e pa vend fjalën shqipe me fjalë të huaja, mosrespektimin e gjuhës standarde dhe të folurin e shkujdesur, pa e vrarë mendjen, se po cungon apo dëmton gjuhën shqipe. Fjala e huaj është e para që na vjen në përdorim, në krahasim me shqipen edhe kur përshëndetemi në rrugë, komunikimet në celular apo njoftime e shumta në rrjetet sociale, ku dominon dëshira për t'u dukur dhe për të qenë *in- të kohës!* Problem tjetër shqetësues për shoqërinë dhe gjuhën tonë mbetet edhe përdorimi i fjalëve të shkurtra, sidomos në jetën e përditshme apo edhe në televizione *si p.sh. puc ciao, by, tkxh*, duke cunguar kështu gjuhën standarde, identitetin e kombit. Nuk dihet akoma se, përse ndodh e gjithë kjo “sjellje” me gjuhën! Mos ndoshta për të qenë të kohës (trendy/cool), për të treguar që zotërojmë një gjuhë të huaj, ndodh sepse ndihen më mirë, e bëjmë se jemi servilë të të huajve apo se jemi të pandjeshëm ndaj gjuhës?! Kjo mbetet për t'u diskutuar në të ardhmen.

Në të vërtetë, a ka shqipja mundësi t'i qëndrojnë kësaj hapeje kulturore, këtyre ndikimeve dhe trysnive gjithnjë e më të mëdha nga jashtë?

Për shkak të kësaj hapeje të madhe të politikës, të ekonomisë dhe të kulturës së vendit tonë ndaj botës, gjuha shqipe, ndryshe nga gjuhët e tjera të botës, nuk ka fuqi të mjaftueshme për t'u përballur me vrullin e fjalëve të huaja, siç do të mund t'u qëndronin gjuhët më të mëdha, si: anglishtja, gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja, turqishtja e të tjera, të cilat kanë me dhjetëra miliona folës, madje edhe me një traditë më të gjatë drejtshkrimi, në krahasim me shqipen. Diskutimi nuk mbyllet me kaq, pasi çështja që krijon debat sot, ndër gjuhëtarë, sociologë, kulturologë është fakti se si do t'i shqiptojmë, si do t'i shkruajmë këto fjalë me prejardhje të huaj? Drejtshkrimi i fjalëve të huaja përbën në ditët tona një debat të gjerë, i cili po pret që të marrë një zgjidhje dhe kjo jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vende të ndryshme të botës, pasi anglishtja po pushton vrullshëm, gjithnjë dhe më shumë botën, duke u bërë kështu “mbretëresha e globit”.

Po “Drejtshkrimi i gjuhës shqipes”, çfarë zgjidhjeje ofron?

Në Kongresin e Drejtshkrimit⁴ të (1973) janë përcaktuar rregulla dhe parime sa i takon fjalëve të huaja dhe shqiptimit të tyre. Edhe në konferenca shkencore është diskutuar e kërkuar zgjidhje për shkrimin e fjalëve dhe emrave me prejardhje të huaj. Në *Drejtshkrimin e gjuhës shqipe*, fjalët me burim të huaj janë përshtatur më së shumti sipas parimit fonetik, parimit themelor të gjuhës shqipe (që fjalët të shkruhen siç shqiptohen). Parimi fonetik është zbatuar për ato fjalë, shqiptimi

⁴ *Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë, Tiranë, 1973, f. 23.

Rreth fjalëve me prejardhje të huaj dhe drejtshkrimit të tyre në shqipe

letrar i të cilave është i njësuar dhe i përgjithësuar prej kohësh. P.sh. *çiklist, injorant, inxhinier*. Ky parim bazë i drejtshkrimit ka qenë i vlefshëm për vite me radhë, por sot, gjuha shqipe, ndodhet në një situatë krejt të re, të paparashikuar fare nga Drejtshkrimi i 73-shit. Gjuha shqipe po ‘popullohet’ gjithnjë e më shumë prej fjalësh, emrash me grafi të gjuhëve prej nga depërtojnë, me qindra fjalë nga fusha të ndryshme leksikore, të shkruara si në gjuhët nga vijnë p.sh. *close, muzikë live, welcome, open, fast food, website, cool, bar, wine, ice cream* etj. Natyrshëm lind pyetja: Këto fjalë me prejardhje të huaj do të shkruhen sipas vendit të origjinës apo do të përshtaten me grafisë e shqipes, d.m.th. pak a shumë siç shqiptohen? Akoma dhe tani që flasim nuk është gjetur një zgjidhje konkrete për këto raste. Të themi që do të merret parasysh ‘shqiptimi i njësuar dhe i përgjithësuar’ i huazimeve, nuk e dimë ende, sepse te drejtshkrimi i 73-shit kemi, jo pak raste, kur ky shqiptim i njësuar dhe i përgjithësuar nuk është marrë parasysh, është shpërfillur në emër të trajtave më të natyralizuara. Pra është kodifikuar trajta sipas “zgjidhjes” që kanë dhënë gjuhëtarët. Janë “çetimologjizuar fjalët”⁵ prej gjuhëtarëve, duke u shpërfillur në këtë mënyrë shqiptimi i ngulitur. P.sh. janë kodifikuar me një trajtë fonetike të latinizuar *certifikatë, ciklamin, proces*. Janë standardizuar trajtat me *gj* në vend të *g* me fonetizëm latin ose *xh* nga italishtja p.sh. *gjest për xhest*. Kjo mendojmë të ketë qenë dhe arsyeja, siç na rezulton nga vëzhgimet, pse trajtat standarde të këtyre fjalëve nuk janë përqafuar nga përdoruesit.

Moda gjuhësore, hapësira e fjalës së lirë, ka bërë që gjuha shqipe të ndihet e “rrezikuar” nga fjalët me prejardhje të huaj

Huazimi është një proces i natyrshëm, i domosdoshëm për çdo gjuhë letrare bashkëkohore, ndaj ai shërben si plotësim i vlefshëm i sistemit të saj leksikor, nëpërmjet procesit të huazimit gjuha (shqipe) pasurohet, (d.m.th. kur ajo fut në sistemin e saj fjalë të huaja të nevojshme) theksojmë, vetëm kur ky proces bëhet sipas rregullave të caktuara që ka çdo gjuhë, por kur ky huazim bëhet pa kriter, pa ju përmbajtur rregullave të shqipes (në rastin tonë), atëherë huazimi e dëmton rëndë gjuhën standarde, duke çuar në humbjen e identitetit të saj. Fillimisht po ndalemi te prania e fjalëve me prejardhje të huaj të nevojshme⁶, të domosdoshme. Thamë që futja e këtyre fjalëve të huaja përkrah shqipes përbën pasuri, sepse në radhë të parë vetë dukuria e huazimit të fjalëve nga gjuhët e huaja zgjeron mundësitë e saj shprehëse. Nëpërmjet huazimeve krijohen neologjizma të rinj. Vetvetiu nga njëra anë, kjo marrëdhënie globaliste bën të mundur që gjuha shqipe të jetë më e hapur ndaj ndërkombëtarizmave, duke na bërë më bashkëkohorë, më të përshtatshëm për nevojat e mijëvjeçarit të ri. P.sh. Në rast se shqipfolësit do të dinë që:

- *Prezantoj do të thotë- paraqes*
- *Aktual- i sotëm, i kohës,*

⁵ K. Jorgaqi, *Vështrim mbi drejtshkrimin e fjalëve me prejardhje të huaj në shqipe*, Tiranë, 2003, f. 218-229.

⁶ Xh. Lloshi, *Shqipja gjuhë e hapur dhe dinamike*, Tiranë, 2003, f. 87-97.

- *Evitoj- shmang, mënjanoj*
- *Evident-i qartë, i dukshëm.*
- *Informoj-lajmëroj, bëj me dije*
- *Aksent- theks*

Atëherë, pavarësisht se në cilin vend të botës ndodhemi, ne do të kemi një çelës, për të ruajtur gjuhën tonë (folësi ka një horizont të plotë në mendjen e tij). Përdorimi dhe i fjalës së huaj dhe i shqipes në të njëjtin vend përbën një pasuri dhe jo dobësi të saj.

Po nga ana tjetër, kjo epokë globaliste ka edhe ndikimin e saj negativ, sa i takon gjuhës standarde, sepse janë kthyer në përdorim të zakonshëm një fond i gjerë fjalësh me prejardhje të huaj, të panevojshme për shqipen edhe pse ajo i ka gjegjëset e saj të bukura.

- Çekap – kontroll
- Kompetitiv – konkurrues
- Amendim- Korigjim
- Moderator – drejtues, ndërmjetës
- Ekstravagancë – teprim, sjellje e çuditshme
- Eloquent – rrjedhshëm, bindës
- Grata – i dëshirueshëm
- Polen-pjalm
- Progres-përparim
- Abrogim- shfuqizim
- Abuzim, abuzoj,abuzohet - shpërdorim, shpërdorohet, shpërdorohet
- Aprovim- miratim
- Evitoj - mënjanoj shmang
- Radikal – rrënjësor
- In-brenda
- prevalon-mbizotëron,
- evakuim-boshatisje,
- cool-i,e kohës, bashkëkohor

Gjithashtu në gjuhë kanë hyrë edhe terma e fjalë të huaja, që emërtojnë nocione, dukuri dhe forma të reja organizimi, si p.sh. termat: *alokim (caktim/dhënie e një shume parash/përpjesëtim buxheti)*, *audit-auditor*⁷ (*rishqyrtim-rishqyrtues*), *audicion (provë dëgjimi/dëgjimi i palëve) etj.*

Përfundime

Fjalët e huaja kanë hyrë në mënyrë të pandërprerë, me intensitet të ndryshëm në periudha të ndryshme. Prania e fjalëve të huaja në një gjuhë është e domosdoshme, sepse përmes këtij procesi pasurohet leksiku, por kur përdorimi i tyre është i tepërt, pa ndonjë kriter të mirëfilltë, thjesht dhe vetëm për t'i treguar të tjerëve që ti zotëron një gjuhë të huaj, atëherë gjuha shtrembërohet, cungohet, duke u shndërruar në një mishmash të vërtetë. Pavarësisht të gjitha këtyre rasteve

⁷ H. Pasho, *Në qoftë se vazhdojmë kështu, nuk do ta njohim më gjuhën tonë.*

Rreth fjalëve me prejardhje të huaj dhe drejtshkrimit të tyre në shqipe

me vend ose jo, të kontrolluara apo të pakontrolluara, gjuha shqipe ka vërtet nevojë për një përkujdesje më të madhe në disa drejtime, sidomos në çështjet e të huazuarit gjuhësor, për të mbetur e unifikuar në të gjitha trojet ku ajo flitet, shkruhet dhe është gjuhë zyrtare. Gjuha standarde, si mjeti themelor i kulturës shqiptare ka nevojë ta lëvrojmë, ta përpunojmë dhe ta përmirësojmë. Ta ruajmë e ta modernizojmë, jo ta humbasim atë. Dihet që në këtë botë globaliste, gjuhët e popujve të vegjël janë me të rrezikuara. Ndaj duhet të hartojmë politika gjuhësore ose planifikime gjuhësore, që i përgjigjen rrethanave të reja që kërkon gjuha standarde. Planifikime që mbrojnë gjuhën tonë që të mos kthehet në një gjuhë hibride. Në veçanti mendojmë së është e udhës që të rishikohet, të ripunohet me vëmendje kreu mbi fjalët dhe emrat me prejardhje të huaj, të futet një kapitull shtesë ose një shtojcë për fjalët e huaja, me më shumë rregulla përgjithësuese, sesa përjashtuese. Kështu do të kemi një përdorim sa më praktik dhe më të gjerë. E gjithë kjo do të jetë në të mirë të vendit dhe gjuhës standarde. Duhet të ndjeshmërohemi të gjithë, sepse gjuha, siç ka thënë dhe Martin Haideger⁸ “është diçka aq e rëndësishme, saqë nuk duhet t’ua lëmë vetëm gjuhëtarëve”. Përpara se kjo dukuri të marr përmasa të gjera, të gjithë duhet të japim kontributin tonë!

⁸ R. Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit – Tridhjetë vjet pas*, Tiranë, 2003, f. 36-41.

